

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.895, DATË 21.12.2016 “PËR KRITERET E ECURISË DHE FITIMIT TË GRADAVE, NJËSIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË, PARAQITJEN, FORMËN DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË GRADAVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim ndryshimin e disa emërtimeve të disa gradave të nivelit të mesëm të shërbimit zjarrfikës, për shkak të ndryshimeve ligjore që erdhën me hyrjen në fuqi të ligjit nr.99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në katërmujorin e parë të programit analitik të projektakteve për vitin 2026, për ministrinë e Punëve të Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” ka qenë detyrim ligjor i përcaktuar në pikën të nenit 22 të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

“Kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, tabela e njësimit të funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ne kuadër të konsolidimit të kuadrit nënligjor për strukturat e shërbimit të MZSH-së, ndryshimeve që ka pësuar ligji nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimin”, për shkak të miratimit të ligjit nr.99/2024, datë 12.9.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” vlerësohet si e domosdoshme ndryshimi i këtij vendimi.

Së pari ky projektvendim duhet të ndryshojë për shkak të ndryshimit që ka pësuar neni 22 i ligjit nr.152/2015 ku janë zëvendësuar fjalë në shkronjat “a”, “b” dhe “c” ku fjalët “Inspektor Zjarrfikës”, Kryeinspektor Zjarrfikës” dhe Komisar Zjarrfikës” janë zëvendësuar me fjalët “Nënkomisar Zjarrfikës”, Komisar Zjarrfikës” dhe “Kryekomisar Zjarrfikës”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” gjatë zbatimit të tij të ekujvalentimit të gradave policore në grada të shërbimit zjarrfikës evidentoi nga disa problematika, lidhur me funksionet korrenponduese në bashkitë qendër qarku me funksionet korrensponduse në bashkitë jo qendër qarku, trajtim i cili i vendos disa nga punonjësit zjarrfikës në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, ndryshe trajtoheshin disa funksione në bashkitë qendër qarku dhe në bashkitë jo qendër qarku.

Gjetjet dhe vështirësitë e implementimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 diktuan nevojën edhe për disa ndryshime në të vendim, dhe kryesisht ndryshime që kanë të bëjnë me lidhjen nr. 1 bashkëlidhur vendimit. Efektet e pritshme me miratimin e këtij projekt vendimi janë pozitive, pasi garantohet vazhdimësia në detyrë e punonjësve të shërbimit të MZSH-së, motivimi i tyre për ecurinë në karrierë, duke garantuar përmirësimin e performancës në përmbushjen e detyrave sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe inkuadrimi i gradave implementimi në përputhje me parimin e proporcionalitetit edhe i emërtimeve të reja të gradave për shkak të miratimit të ligjit nr. 99/2024.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në përputhje me Kushtetutën, në zbatim të pikës 2 të nenit 22 të Ligjit nr.152, datë 21.12.2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pika 1 e projektvendimit parashikon që në pikën 3 dhe në lidhjen nr. 2, të parashikuar në pikën 8, të vendimit nr. 895, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ecursisë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, fjalët “Inspektor Zjarrfikës” zëvendësohen me fjalët “Nënkomisar Zjarrfikës”, fjalët “Kryeinspektor Zjarrfikës” zëvendësohen me “Komisar Zjarrfikës”, fjalët “Komisar Zjarrfikës” zëvendësohen me “Kryekomisar Zjarrfikës”.

Pika 2 parashikon që lidhja nr. 1, “Tabela e ekuivalentimit të gradave dhe e funksioneve korresponduese për çdo gradë”, e vendimit në fuqi, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me titull “Tabela e njësimit të funksioneve korresponduese për çdo gradë”, bashkëlidhur këtij vendimi.

Pika 3 parashikon që për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në fund parashikohet hyrja në fuqi e vendimit, e cila ndodh pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.895, datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecursisë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

ALBANA KOÇIU

